



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Ministria e Punëve të Jashtme - Ministarstvo Inostranih Poslov - Ministry of Foreign Affairs

Kabineti i Ministrit - Kancelarija Ministra - Cabinet of the Minister

Nr. 147/2016

Datë: 20.04.2016

Ministri i Punëve të Jashtme i Republikës së Kosovës,

Duke marrë parasysh dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-199 për ratifikimin e marrëveshjes së parë Ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes për aranzhimet e zyrtarëve ndërlidhës e datës 31 Maj 2013, në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-219 për të Huajt si dhe në pajtim me Nenin 8 (nënparagrafi 1.4) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive,

Duke marrë parasysh se raporti monitorues i OSBE-së, Raporti i Komisionerit për të drejta të njerit të Këshilli të Europës, raportet e Komisionit European, raporti i Qendrës për të Drejtën Humanitare dhe Raporti i Human Rights Watch, konstatojnë se në Serbi ka probleme të theksuara dhe pengesa shtetërore në ndjekjen e kriminelëve të luftës të dyshuar për krime lufte në Kosovë, nxjerr

VENDIM

1. Bartësve të funksioneve të ministrave/eve të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Serbisë; ju ndalohet hyrja në Republikën e Kosovës përderisa nuk pranojnë ftesë zyrtare dhe individuale nga homologët e tyre në Republikën e Kosovës.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme dhe të gjitha autoritetet përkatëse për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Petrit SELIMI

Ministër i Punëve të Jashtme i Republikës së Kosovës

Vendimi u dërgohet:

- Zyrës së Kryeministrit;
- Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Ministrisë së Forcës dhe Sigurisë;
- Policisë së Kosovës;
- Arkivit të MPJ-së.

